

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6734
E martë, 18 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Disa universitete në Shqipëri e nisin vitin akademik me protesta **FAQE 8**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



FSK-ja FITON MEDALJE TË ARGJENTË NË GARËN USHTARAKE "CAMBRIAN PATROL '22" F. 7

POLICIA NË PRISHTINË VAZHDON KONTROLLET PËR RUAJTJEN E SIGURISË F. 6

CRAMON: KOSOVA DHE SERBIA DUHET TA KONSIDEROJNË SERIOZISHT OFERTËN E PARISIT DHE BERLINIT F. 5

EKONOMI



"FLUTUROJNË" ÇMIMET NË KOSOVË: ÇAJI BËHET 10 EURO, NJË METËR DRU 67 EURO F. 8

KURTI PRET NË TAKIM BORDIN E DREJTORËVE TË KEK-ut, DISKUTOHET PËR KRIZËN ENERGETIKE F. 8

SPORT



ARMEND THAQI, 'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË F. 10

DEPUTETI PORTUGEZ: NUK KA ARSYE QË KOSOVA TË HASË NË PENGESA NË RRUGËN E SAJ DREJT BE-së



Një delegacion i Komisionit për Politikë të Jashtme të Portugalisë po qëndron për vizitë në Kosovë. Në takimet që ka pasur kryetari i këtij delegacioni portugez, Sergio Sousa Pinto, me zyrtarë të Kuvendit të vendit tonë, ka theksuar se shteti i tij do ta përkrahë Kosovën sa i përket liberalizimit të vizave. Ai ka thënë

se nuk ka asnjë arsye që Kosova të hasë në pengesa në rrugën drejt BE-së. Ndërkohë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me stagnimin e procesit të liberalizimit të vizave, duke theksuar se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret e kërkuara

TAHIRI KËRKON ANGAZHIM TË KUVENDIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE **FAQE 3**



VUÇIQI DHE LAJÇAKU BISEDOJNË PËR ÇËSHTJET E HAPURA NË DIALOG **FAQE 7**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vuçiqi dhe Lajçaku bisedojnë për çështjet e hapura në dialog

PRISHTINË, 17 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se ka zhvilluar një bisedë serioze dhe të përgjegjshme me përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, lidhur me çështjet e hapura në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë.

Pas takimit me Lajçakun, Vuçiqi ka përsëritur se Serbia insiston në zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura deri më tani në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. "Një bisedë serioze dhe e përgjegjshme me Miroslav Lajçakun mbi çështjet e hapura në dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit. Ne do të vazhdojmë të luftojmë që ta ruajmë shtetin dhe popullin tonë, duke insistuar në zbatimin e plotë të

marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe në respektimin e ligjit ndërkombëtar", ka shkruar Vuçiqi në "Instagram".

Lajçaku vizitoi Beogradin katër ditë pasi qëndroi në Prishtinë, ku u takua me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.

Pas atij takimi është thënë se përshkallëzimi nuk është në interesin e askujt.

Lajçaku u ka thënë gazetarëve në Prishtinë se me kryeministrin Kurti kanë diskutuar disa tema, përfshirë atë të rregjistrimit të veturave me targa serbe në RKS (Republika e Kosovës).

Ai ka përmendur se afati për reregjistrim skadon më 31 tetor dhe se bashkësia ndërkombëtare dëshiron të dijë se cilat janë planet në këtë drejtim.

Deri më tani Qeveria e Kosovës

ka thënë se afati për reregjistrim nuk do të shtyhet dhe se nga 1 nëntori nuk do të mund të qarkullojnë më makinat me targa të lëshuara nga Serbia.

Këto targa konsiderohen të paligjshme nga autoritetet në Kosovë, mirëpo deri më tani janë toleruar në veri të Kosovës.

Më 31 korrik dhe 1 gusht serbët lokalë në veri të Kosovës kanë vendosur barrkada si shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për zbatim të dy vendimeve: për targat e makinave dhe dokumentet serbe.

Vendimi për zbatim të këtyre dy vendimeve është shtyrë për 1 shtator, edhe me kërkesë të mekanizmave ndërkombëtarë.

Ndërkohë është arritur marrëveshje për dokumentet për



hyrje/dalje.

Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Procesi i negociatave pritet të

përfundojë me marrëveshje ligjërish të detyrueshme.

Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranoi, duke insistuar në "zgjidhje kompromisi".

NATO-ja mban stërvitje 'të rregullta' për mbrojtje bërthamore

BRUKSEL, 17 TETOR - NATO-ja ka nisur stërvitjet e rregullta për mbrojtje bërthamore në Evropën Perëndimore në kohën e rritjes së tensioneve me Rusinë, të nxitura nga kërcënimet e presidentit rus Vladimir Putin. "Stërvitjet përfshijnë 14 shtete dhe mbi 60 lloje të pajisjeve, përfshirë aeroplanët luftarakë të kategorisë së katërt dhe pestë, si dhe pajisjet për vëzhgim", ka thënë aleanca 30-anëtarëshe përmes një deklarate, duke shtuar se këto "aktivitete rutinore" - që zgjasin deri më 30 tetor - kanë qenë të planifikuara edhe para nisjes së luftës në Ukrainë dhe nuk janë të lidhura me situatën aktuale. Stërvitjet do të zhvillohen mbi Belgjikë, Britani dhe Detin Verior. "Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, i miratuar nga vendet aleate në Samitin në Madrid, të



mbajtur në qershor, e bën të qartë 'se qëllimi i kapacitetit bërthamor të NATO-s është për ta ruajtur paqen dhe për ta

luftuar agresionin", është thënë në deklaratë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka

hedhur poshtë çfarëdo thirrje për t'i anuluar stërvitjet, meqë Putini e ka përkeqësuar retorikën bërthamore, pas

humbjeve të forcave ruse kundrejt atyre ukrainase. "Do të dërgonte mesazh shumë të keq nëse do të anulonim papritur një stërvitje rutinore, të planifikuar për kohë të gjatë", ka thënë Stoltenbergu javën e kaluar. "Ne duhet të kuptojmë që qasja e vendosur e NATO-s dhe fuqia jonë ushtarake janë mënyrat e vetme për ta parandaluar përshkallëzimin". Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Pagat dhe përfitimet shtesë "duhet të rriten në linjë me inflacionin"

NYU-JORK, 17 TETOR - Shtetet duhet të sigurohen që përfitimet sociale dhe pagat të rriten në linjë me inflacionin, në të kundërtën njerëzit mund të përballen me uri apo të kenë shtëpi të ftohta, ka thënë Olivier De Schutter, ekspert i Kombeve të Bashkuara për varfërinë ekstreme dhe të drejtat e njeriut. "Nuk është hiperbolë nëse them që nëse qeveritë nuk rrisin përfitimet dhe pagat në përputhje me inflacionin, do të ketë jetë të humbura", ka thënë ai.

Rritja e kërkesës për produkte dhe shërbime të tjera, pas heqjes së masave kufizuese për luftim të pandemisë së koronavirusit, dhe lufta e Rusisë në Ukrainë, besohet se janë dy shkaqet kyçe që kanë ndikuar në rritje të inflacionit në shumë vende të botës. "Sikurse me pandeminë e koronavirusit, më të cenueshmit janë duke paguar çmimin e zhvillimeve botërore. Krizat e kombinuara pritet të përballin 75 deri në 95 milionë njerëz më shumë me varfëri

ekstreme vetëm këtë vit. Qoftë në Evropë, ku inflacioni ka prekur një rekord prej 10-përqindësh, apo në Afrikën nënsahariane, ku çmimet e ushqimit janë rritur për gati 24 për qind, buxhetet familjare në gjithë botën janë duke tkurrur përtej pikës kritike", ka thënë ai. Kjo nënkupton se "edhe më shumë njerëz në varfëri do të jenë të uritur apo do të kenë të ftohtë këtë dimër në rast se nuk merren masa të menjëhershme për t'i rritur të hyrat e tyre".



Disa universitete në Shqipëri nisin vitin akademik me protesta

TIRANË, 17 TETOR - Viti i ri akademik në Shqipëri nisi të hënën me bojkot dhe protestë nga ana e disa pedagogëve në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Gjirokastër. Përjashtim bën Universiteti i Mjekësisë, ku mësimi nisi normalisht, si dhe dy universitetet në Vlorë dhe Korçë, "Ismail Qemali" dhe "Fan Noli". Nga ora 08:00-10:00 u mirëpritën studentët e vitit të parë në departamentet e tjera, por nuk u zhvillua mësim. Më pas, rreth dy orë, shumica e

pedagogëve u mbledhën para fakulteteve ku japin mësim për të protestuar. Megjithatë, pati edhe përçarje mes pedagogëve, pasi jo të gjithë iu bashkuan protestës. Pedagogët në Shqipëri i nisën protestat prej datës 15 shtator dhe deri më 17 tetor kanë realizuar katër sosh me kërkesa kryesore: rritjen e pagës për 50 për qind, rritjen e pagesës për orët shtesë dhe rritje të financimit për kërkimin shkencor. Dy javë më parë qeveria mori vendim për rritje të pagave për

pedagogët dhe stafin e ndihmës për 7 për qind. Aktualisht pagat e pedagogëve në arsimin e lartë në Shqipëri variojnë nga 73 mijë lekë (rreth 630 euro) më e ulëta deri në 130 mijë (rreth 1 120 euro), varësisht prej titujve dhe pozitës që ata kanë në fakultet. Protesta e së hënës u mbyll në orën 12:00. Kreu i Sindikatës së Punonjësve të Arsimit të Lartë, Sandër Kovaçi, tha se të martën protesta do të nisë prej orës 08:00 të mëngjesit. Ai shtoi se

nuk presin më një përgjigje nga ministrja e Arsimit, Evis Kushi, por nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. "Presim reagimin e sotëm nga qeveria për të vendosur për hapat që do të marrim. Nëse nuk ka reagim, do ta përshkallëzojmë protestën dhe do të mblihdemi para kryeministrit, që zëri ynë të dëgjohet më mirë", tha Kovaçi. Për pedagogët që nuk iu bashkuan protestës, Kovaçi paralajmëroi se do të ketë shumë shpejt një veting për të ardhurat dhe pasuritë që disponojnë.

Edhe pse studentët nuk iu bashkuan në masë protestës, Kovaçi tha se të rinjtë janë përkrah tyre dhe kjo do të shihet në ditët në vijim. Po të hënën studentët që janë pjesë e "Lëvizjes Studentore" kërkuar të ketë një organizim të përbashkët, përmes të cilit t'i adresohen qeverisë për problemet e studentëve. Një nga kërkesat kryesore të studentëve është mbështetja financiare me 100 euro për ta përballuar rritjen e çmimeve.



Lladrovci pret në takim ambasadorin gjerman, e falënderon për përkrahjen në arsim



DRENAS, 17 TETOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Gjermanisë, Jorn Rohde, të cilin e ka falënderuar për përkrahjen në arsim. Lladrovci e ka njoftuar ambasadorin gjerman me të arriturat dhe sfidat në komunën e Drenasit dhe për bashkëpunimin

e shumanshëm me disa komuna në Gjermani në fushën e arsimit. "Sot, me kënaqësi prita ambasadorin e Gjermanisë në vendin tonë, z. Jorn Rohde. Ambasadorin e njoftova për të arriturat dhe sfidat në komunën e Drenasit si dhe për bashkëpunimin e shumanshëm të komunës sonë me disa komuna në Gjermani në fushën e

arsimit. Ambasadori Rohde u interesua, po ashtu, lidhur me fabrikën e Ferronikelit si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet komuna e Drenasit. E falënderova ambasadorin për mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë në shumë fusha, në veçanti për mbështetjen e arsimit në komunën e Drenasit", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".

Një i vdekur dhe katër raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 17 TETOR - Në 24 orët e fundit në Kosovë si pasojë e Covid-19 ka humbur jetën një person. Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë

konfirmuar 4 raste të reja pas 38 testimëve dhe katër të shëruar, derisa numri i rasteve aktive është 21. Kosova deri më sot ka administruar gjithsej 1 836 378

vaksina kundër Covid-19. Me dozën e parë janë vaksinuar 904 370 qytetarë, me dozën e dytë 824 767, me dozën e tretë 105 250, ndërsa me dozën e katërt 1 798 qytetarë.





Deputeti portugez: Nuk ka arsye që Kosova të hasë në pengesa në rrugën e saj drejt BE-së

Një delegacion i Komisionit për Politikë të Jashtme të Portugalisë po qëndron për vizitë në Kosovë. Në takimet që ka pasur kryetari i këtij delegacioni portugez, Sergio Sousa Pinto, me zyrtarë të Kuvendit të vendit tonë, ka theksuar se shteti i tij do ta përkrahë Kosovën sa i përket liberalizimit të vizave. Ai ka thënë se nuk ka asnjë arsye që Kosova të hasë në pengesa në rrugën e saj drejt BE-së. Ndërkaq deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me stagnimin e procesit të liberalizimit të vizave, duke theksuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 17 tetor - Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme në Parlamentin e Portugalisë, Sergio Sousa Pinto, ka thënë se shteti i tij do ta përkrahë Kosovën sa i përket liberalizimit të vizave. Ai pas takimit me deputetët e Kuvendit të Kosovës, pjesë e Komisionit për Punë të Jashtme, shtoi se mbështetje do të ketë Kosova edhe për anëtarësim në BE. Miqësi shumëvjeçare ai e ka quajtur raportin me Kosovën, duke ripërsëritur mbështetjen në të gjitha fushat. "Jemi këtu për ta treguar mbështetjen tonë.

Ne do ta mbështesim Kosovën, ngaqë kemi një lidhje emocionale me ju, numër i madh i forcave të Portugalisë janë në Kosovë. Do t'ju mbështesim për liberalizimin e vizave dhe anëtarësim në Bashkimin Evropian. E ardhmja e Kosovës është në union dhe do ta keni të gjithë mbështetjen tonë diplomatike", ka thënë Pinto. Ndër të tjera, përfaqësuesi i delegacionit portugez, Sergio Sousa Pinto, ka falënderuar Komisionin për pritjen e ngrohtë dhe miqësore, duke bërë me dije se Parlamenti i Portugalisë së shpejti do ta formojë Grupin e Miqësisë me Kosovën. "Grupi i Miqësisë do të formohet

dhe Kosova do të trajtohet me prioritet", ka thënë Pinto. Duke folur për procesin e integrimi, Pinto ka vlerësuar se nuk ka asnjë arsye që Kosova të hasë në pengesa në rrugën e saj drejt BE-së.

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi, i ka uruar mirëseardhje këtij delegacioni dhe e ka falënderuar për ndihmën e deritanishme që Portugalia ka treguar ndaj vendit tonë.

Në vazhdim të takimit Abazi ka folur për angazhimet parlamentare që ndërlihen me proceset integruese të vendit, përkatësisht sfidat dhe sukseset me të cilat ballafaqohen në këtë rrugëtim.

Duke folur për prioritetet e politikës së jashtme të vendit, kryetari Abazi nënvizoi rëndësinë e liberalizimit të vizave, anëtarësimin në Këshillin e Evropës dhe në NATO, si dhe njohjen e shtetësisë së Kosovës nga pesë shtetet e BE-së, të cilat ende nuk e kanë marrë këtë vendim.

Për të qenë edhe më të suksesshëm në përpjekjet integruese të vendit tonë, Abazi kërkoi që mbështetja dhe bashkëpunimi portugez të

thellohen edhe më tej, veçanërisht bashkëpunimi ndërparlamentar.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit vlerësuan se shkëmbimi i përvojave ndërmjet të dyja parlamenteve është i mirëseardhur, ndërkaq u angazhuan që ky bashkëpunim të thellohet dhe zgjerohet edhe në fusha të tjera, veçanërisht në atë të ekonomisë, turizmit dhe arsimit.

Në kuadër të takimeve me anëtarët e komisioneve të Kuvendit të Kosovës, të hënën delegacioni i Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Republikës së Portugalisë u prit edhe nga Komisioni për Integrim Evropian.

Diskutimi u zhvillua kryesisht mbi rrugëtimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Kryetarja e komisionit, Rrezarta Krasniqi, duke shprehur mirënjohje për vizitën e delegacionit nga parlamenti i Portugalisë, falënderoi mysafirët për mbështetjen që Lisbona zyrtare ka dhënë për Kosovën në procese të ndryshme.

Krasniqi ka theksuar nevojën që kjo mbështetje të vazhdojë edhe

në të ardhmen, veçanërisht në sferën e integritit euroatlantik e të konsolidimit të mëtejshëm të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Sipas saj, tani, në kohën kur lufta në mes të Ukrainës dhe Rusisë është duke ndodhur, më shumë se kurrë të gjitha shtetet evropiane duhet të qëndrojnë të bashkuara.

Sergio Sousa Pinto, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme në Parlamentin e Portugalisë, siguroi anëtarët e komisionit të Kuvendit të Kosovës se shteti i tij do të bëjë gjithçka që është e nevojshme që Kosova të jetë anëtare me të gjitha të drejtat sikurse shtetet e tjera të BE-së.

Anëtarët e Komisionit për Integrim Evropian ngritën shqetësimin e tyre lidhur me stagnimin e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën. Ata thanë se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara dhe se liberalizimi i vizave dhe anëtarësimi në NATO janë dy aspirata të kamotshme të qytetarëve të Kosovës.

Takimi u përmbyll me zotimin se për të gjetur ura të reja bashkëpunimi midis Kosovës dhe Portugalisë në fusha të ndryshme të interesit reciprok.

Më 4 nëntor mbahet konferenca e radhës mbi ecurinë e çështjes në rastin e ish-liderëve të UÇK-së

PRISHTINË, 17 TETOR - Konferenca e radhës mbi ecurinë e çështjes kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është caktuar të mbahet më 4 nëntor në orën 13:30. Lajmin e kanë bërë me dije Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Në konferencën e fundit mbi ecurinë e çështjes kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjykatësi ka urdhëruar Zyrën e Prokurorit të Specializuar që deri më 18 nëntor 2022 të dorëzojë një listë paraprake me 40 dëshmitarët e parë që synon t'i thërrasë.

Gjithashtu, ai ka urdhëruar mbrojtjen që të dorëzojë deri më 28 tetor 2022 njoftimet për alibi, ose arsyet që përjashtojnë përgjegjësi penale, dhe ka urdhëruar që mbrojtja të dorëzojë njoftim për çfarëdo mundësie hetimore unike që do të përdorë deri më 7 tetor 2022.

Aktakuza ndaj Thaçit dhe të tjerëve lidhur me pretendimin për krime lufte është konfirmuar më 26 tetor 2020, ndërsa në paraqitjet e tyre të para në Dhomat e Specializuara në Hagë ata janë deklaruar të pafajshëm. Ata janë duke qëndruar në paraburgim në Hagë prej

nëntorit të vitit 2020. Më 29 prill Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit ku pretendon se të akuzuarit kanë kryer krime lufte në Gjilan, Budakovë e Semetishtë.



Cramon: Kosova dhe Serbia duhet ta konsiderojnë seriozisht ofertën e Parisit dhe Berlinit

PRISHTINË, 17 TETOR - Raportuesja e Parlamentit Evropian për Kosovën, Viola von Cramon, ka thënë se Prishtina dhe Beogradi duhet ta konsiderojnë seriozisht ofertën e Parisit dhe Berlinit. Kjo pasi, sipas saj, siç shkruajnë mediet serbe, "është e mundur që tjetra të mos jetë më e mirë se e fundit".

Ajo vlerësoi se Beogradi dhe Prishtina duhet të gjejnë "një kompromis të qëndrueshëm dhe 'të gëlltisin disa pilula të hidhura' në rrugën e përparimit". "Ne e mbështesim plotësisht dhe në

mënyrë të palëkundur punën e Miroslav Lajçakut dhe besoj se qëllimi mund të jetë real", tha Viola von Cramon në përgjigje për mediet serbe se i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Lajçak pret që marrëveshja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës të arrihet deri në fund të vitit 2024.

Ajo vlerësoi se Serbia sot është "më së largu që nga viti 2000" nga Bashkimi Evropian. "Unë nuk jam e sigurt se njerëzit në Serbi e dinë se reputacioni i Serbisë është më i keqi që nga viti 1999", ka thënë më tej Viola von Cramon.



Fillojnë punimet për rregullimin e rrugëve në fshatin Haxhaj të Gjilanit

GJILAN, 17 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për rregullimin e rrugëve në fshatin Haxhaj. Gjatë vizitës në këtë fshat, kreu i Gjilanit ka njoftuar se vlera e këtij projekti është mbi 111 mijë euro. “Kanë nisur këto

ditë punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatin Haxhaj në gjatësi 877 metra. Projekti në vlerë 111 660.51 zgjidh problemin e kamotshëm të banorëve. Po punojmë në çdo cep të komunës!”, ka thënë kryetari Hyseni.



Policia në Prishtinë vazhdon kontrollet për ruajtjen e sigurisë

PRISHTINË, 17 TETOR - Policia e rajonit të Prishtinës po vazhdon kontrollet e shtuara policore me qëllim të ruajtjes dhe ngritjes edhe më tej të nivelit të sigurisë. Gjatë fundjavës nga njësitë për

reagim të shpejtë në dy lokacione të ndryshme janë gjetur dhe sekuestruar dy armë zjarri. Personat e dyshuar janë shoqëruar në stacionet përkatëse policore dhe ndaj tyre

është iniciuar rast për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës dhe, në konsultim me prokurorin e shtetit, ata janë proceduar për më tej.

Mbyllet festivali ‘Mitrovica Guitar Days’

MITROVICË, 17 TETOR - Festivali tradicional “Mitrovica Guitar Days” për disa net rresht ka sjellë në qytetin e Mitrovicës kitaristë ndërkombëtarë dhe vendorë, koncerte dhe master klasa nga kitaristë të ndryshëm.

Ky festival është mbajtur në sallën e muzeut të qytetit, ku të pranishëm ishin ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Valdete Idrizi, zëvendësambasadorja e ShBA-së në Kosovë, Alyson Grunder, drejtori i festivalit, Erhan Mujka, studentë, artistë dhe shumë artdashës.

Në fjalën e saj drejtoresha Valdete Idrizi ka theksuar se si komunë ndihen të lumtur që kanë përkrahur festivalin “Mitrovica Guitar Days” dhe që janë partnerë në këtë festival tradicional. “Jemi ndër komunat e rralla, mos të them e vetme, që prioritetin e dytë, krahas me arsimin, e kemi kulturën, sepse besojmë se një qytet zhvillohet duke e zhvilluar kulturën e sidomos një qytet me



traditë të kulturës si në muzikë klasike, rok jazz dhe në të gjitha fushat e tjera. Artistët padyshim janë ambasadorët më të mirë të

vendit tonë e ne si Mitrovicë kemi shumë”, ka thënë drejtoresha Idrizi.

Festivali i cili ishte i hapur me datat

6-12 tetor ka filluar me performancën e mrekullueshme të kitaristit me renome botërore, Aniello Desiderio, i cili për

publikun ofroi një program të pasur artistik, ndërsa gjatë netëve të tjera kanë performuar edhe kitaristë të tjerë të mirënjohur.

2023-a, vit i reformave në transportin publik në Prishtinë

PRISHTINË, 17 TETOR - Nën kryetarja e komunës së Prishtinës, Donjeta Sahatçiu, është takuar me përfaqësues të operatorëve privatë që ofrojnë shërbim të transportit me autobusë në linjat qendrore dhe periferike, përfaqësues të Trafikut Urban në Prishtinë

dhe partnerët nga BERZh-i, për të prezantuar dhe diskutuar planin e veprimit për reformimin e transportit publik. Ajo në “Facebook” ka njoftuar se në vitin e ardhshëm do të ketë reforma në transportin publik në kryeqytet. Sipas saj,

mbështetja e të gjithë operatorëve është e domosdoshme për reformë të mirëfilltë.

Sahatçiu ka bërë me dije se nga viti i ardhshëm qytetarët do të kenë mundësi ta paguajnë trafikun urban përmes SMS dhe CR Code.



Osmani: Liria e fituar nuk është e plotë pa drejtësi për viktimat dhe dënim për autorët

PRISHTINË, 17 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim një delegacion të Rrjetit Global të Viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës nga Ukraina dhe Kolumbia. Në takim me këtë delegacion, presidentja Osmani ka theksuar se historia më e re e Kosovës bart në vete rrëfimin e trishtë të mbi 20 mijë grave të dhunuara gjatë luftës së vitit 1999 nga regjimi gjenocidal i Serbisë. Në këtë kontekst, Osmani ka përmendur guximin e ish-deputetes Vasfije Krasniqi, e cila tri vjet më parë dëshmoi në

Kongresin Amerikan për dhunimet e kryera nga forcat gjenocidale serbe, duke kërkuar drejtësi.

Presidentja Osmani ka theksuar se liria e fituar nuk është e plotë pa drejtësi për viktimat dhe dënim për autorët. Ajo e ka njoftuar delegacionin nga Ukraina dhe Kolumbia se me propozimin e saj, 14 Prilli në Kosovë shënohet si Dita e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale Gjatë Luftës, duke rikonfirmuar se si presidente e vendit do të jetë zëri i këtyre grave çdo ditë.

Presidentja e ka njoftuar

delegacionin se në vitin 2014 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore me të cilat personave të dhunuar gjatë luftës u njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale, me të cilën gjë u mundësohet pensioni ligjor.

Sipas presidentes Osmani, përvoja e Kosovës mund ta ndihmojë Ukrainën në trajtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale. Në këtë drejtim Osmani ka përsëritur se populli i Kosovës është në krah të popullit ukrainas dhe se do ta vazhdojë mbështetjen ndaj tij me të gjitha mundësitë.



Tahiri kërkon angazhim të Kuvendit për liberalizimin e vizave

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 TETOR - Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e cila u mbajt të hënën, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka treguar për çështje që ka ngritur në këtë mbledhje. "E para, ka të bëjë me liberalizimin e vizave. Në kryesi e kam ngritur një çështje që Kuvendi i Kosovës t'i adresohet presidencës çeke dhe të gjithë kryeparlamentarëve të vendeve anëtare, me një kërkesë që lidhet me një mosvendim për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. AAK-ja vlerëson se ky është një diskriminim klasik dhe është një zvarritje e cila nuk duhet të ndodhë", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se çfarëdo sistemi që BE-ja e aplikon për vendet e tjera joanëtare të Shengenit, mund të hyjë në fuqi edhe për Kosovën pasi që të liberalizohen vizat. "Pra, heshtja e Kuvendit nuk është e drejtë dhe për këtë arsye e ngrita këtë çështje te Kryesia e Kuvendit që të ketë një adresim serioz. Në veçanti, duke e ditur që në seancën e fundit miratua nëntë marrëveshje ndërkombëtare, prej tyre shtatë lidhen drejtpërdrejt me BE-në. Heshtja jonë nuk i bën hair dhe as nder Republikës së Kosovës", është shprehur Tahiri. Ai ka thënë se çështja e dytë që ka ngritur në këtë mbledhje ishte ajo për reformat pensionale. "AAK nuk do të mbështet asnjë reformë



në qoftë se nuk votohet amendamenti i ligjit që është propozuar nga AAK-ja e që lidhet me personat të cilëve nuk u njihet stazhi i punës për një ditë. Ka punëtorë në arsim, shëndetësi, polici, që nuk u njihet stazhi i punës për një ditë dhe e humb të drejtën e pensionit të rregullt. Kjo është e pakuptimtë dhe për këtë kërkoja mbështetje nga LV-ja. E treta lidhet me bllokadën

ekonomike në Kosovë. Komunitet janë peng i mosveprimit të qeverisë dhe ligji që është sjell në kuvend nuk është i mjaftueshëm, ka ardhur pa konsultim të organizatave buxhetore, në veçanti të komunave. Kërkojmë që me urgjencë të zhblokojmë fondet e investimeve kapitale dhe të vazhdojmë punimet në komuna. Përndryshe, do të kemi një deficit dhe një rekord të zi për

qeverinë, që nga themelimi i institucioneve qeverisëse në Kosovë. Pra, kjo do të jetë qeveria, e cila në historinë e saj do të jetë më e dobëta në raport me investimet kapitale", ka thënë Tahiri.

Ndërkaq si çështje të katërt, Tahiri ka thënë se ka përmendur Ligjin e Pagave. Sipas tij, ky ligj ka përfunduar procesin e konsultimit publik që një muaj

dhe ende nuk vjen për miratim në Kuvend. "Kjo nënkupton shtyrje edhe për një vit të zbatimit të tij. AAK-ja kërkon që ligji të vijë sa më shpejtë në Kuvend në mënyrë që zbatimi i tij të fillojë nga 1 janari 2023 dhe jo të hyjë në fuqi me 1 janar të vitit 2024. Me ecurinë e deritanishme, ky ligj nuk ka teori të hyjë në zbatim nga janari i vitit të ardhshëm", ka deklaruar Tahiri.

FSK-ja fiton medaljen e argjendtë në garën ushtarake "Cambrian Patrol '22"

PRISHTINË, 17 TETOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) çdo ditë e më shumë po tregon nivel të lartë të përgatitjes profesionale përmes sukseseve që po arrin në gara të ndryshme ndërkombëtare. Së fundmi, ekipi i Forcës së Sigurisë së Kosovës arriti ta marrë medaljen e argjendtë në

njërin prej garave ushtarake më prestigjioze në botë "Cambrian Patrol '22" që u zhvillua në Britani të Madhe.

Në këtë garë pjesëtarët e FSK-së treguan performancë të jashtëzakonshme gjatë stërvitjes 48-orëshe në Malet e Zeza të Uellsit, së bashku me 80 ekipe britanike dhe 27

ekipe të shteteve të tjera ndërkombëtare.

Performanca e FSK-së është vlerësuar lart edhe nga këshilltari i Mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel John Hunter, si demonstrim i qartë i përkushtimit dhe standardeve të larta që FSK-ja ka përmbushur.



"Fluturojnë" çmimet në Kosovë: Çaji bëhet 10 euro, një metër dru 67 euro

PRISHTINË, 17 TETOR - Çmimet e produkteve bazike kanë shënuar rritje në vendin tonë. Një pako çaj është shtrenjtuar 2 euro brenda katër ditëve, pra çmimi ka arritur në 10 euro për pako e cila më herët kushtonte 8 euro. Kështu

është bërë me dije nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

Rritje ka shënuar edhe çmimi për metrin e druve. Sipas ASK-së, një metër dru bung po shitet 67 euro. Çmimi për një metër dru ahu është 50 euro.

Po ashtu, edhe derivatet e naftës kanë shënuar rritje të madhe në krahasim me ditët e kaluara. Në bazë të çmimit të caktuar nga ministria për sot, nafta do të jetë 1 euro e 78 centë, benzina 1 euro e 41 centë dhe gazi 74 centë.



Kurti pret në takim Bordin e Drejtorëve të KEK-ut, diskutohet për krizën energjetike

EPOKA E RE Albulena S. MAVARJ

PRISHTINË, 17 TETOR - Bashkë me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kryeministri Albin Kurti ka pritur të hënën në takim Bordin e Drejtorëve të KEK-ut, kryesuar nga Skender Haziri.

Në takim ishte i pranishëm edhe kryeshefi ekzekutiv i KEK-ut, Nagip Krasniqi.

Rëndësia e punës së KEK-ut, veçanërisht gjatë krizës energjetike dhe sfidat që kjo ndërmarje ballafaqohet, ishin dy prej temave të këtij takimi.

Infrastruktura dhe teknologjia e vjetër e termocentraleve vazhdojnë të mbeten sfidat kryesore. Përkundër kësaj, Bordi i Drejtorëve e njoftoi kryeministrin Kurti rreth masave dhe përgatitjeve, që KEK-u ka bërë për periudhën e dimrit.

Kryeministri Kurti falënderoi Bordin e Drejtorëve të KEK-ut për punën e deritanishme, duke theksuar se ky dimër, përballë krizës globale energjetike, do të varet shumë nga optimizmi i kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike të vendit dhe



racionalizimi i shpenzimit të energjisë elektrike nga ana e institucioneve publike, qytetarëve dhe bizneseve.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se të shtunën në mesnatë njësia A4 e termocentralit Kosova A do të shkyçet me qëllim të sanimit të rrjedhjeve të paraqitura në

kalldaj.

Sipas njoftimit të së shtunës, rikthimi i operimit do të bëhet brenda 4-5 ditëve të ardhshme. KEK-u nuk ka dhënë më shumë detaje, por ka thënë se "për zhvillimet e reja do të njoftoheni me kohë".

Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se në sezonin e

dimrit do të ketë reduktime të energjisë për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese për ta mbuluar kërkesën dhe çmimin e shtrenjtë të importit të rrymës.

Ekzekutivi u ka bërë thirrje qytetarëve që ta kursejnë rrymën gjatë dimrit në mënyrë që niveli i reduktimeve të ulet.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me dy termocentralet Kosova A dhe Kosova B, mund të prodhojë energji deri në 800 megavat në orë, kurse nevojat e konsumatorëve, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavat në orë. Diferenca tjetër sigurohet nga importi.

Zvicra krijoi 500 vende të reja të punës brenda këtij viti në Kosovë



PRISHTINË, 17 TETOR - Ambasada e Zvicrës në Kosovë ka bërë me dije se gjatë këtij viti ka krijuar 500 vende të reja të punës në sektorin privat në vend. Përmes një njoftimi në "Facebook", Ambasada e Zvicrës ka thënë se vendet e reja të punës janë krijuar në sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyrorë dhe

turizmit. "Zvicra vazhdon ta mbështesë krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e sektorit privat në Kosovë. Vetëm këtë vit Zvicra kontribuoi në krijimin e 500 vendeve të reja të punës në sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyrorë dhe turizmit", ka njoftuar Ambasada e Zvicrës në Kosovë.

Në njoftim është thënë se gratë nga komuniteti joshumicë përbëjnë gjysmën e të punësuarve. "Ne jemi të inkurajuar nga fakti që gratë dhe komunitetet joshumicë përbëjnë gjysmën e të punësuarve në këto vende të reja pune", ka njoftuar kjo ambasadë.

Gërxfalio: Rënie shqetësuese e këmbimit tregtar mes Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 17 TETOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxfalio, ka thënë se është shqetësuese rënia e këmbimit tregtar në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Ai ka thënë se të dhënat zyrtare të INSTAT tregojnë se për periudhën janar - gusht 2022

sasia e eksporteve shqiptare në Kosovë shënoi rënie 40 për qind, gjithashtu edhe importet nga Kosova 12 për qind.

"Gjatë tetëmujorit u eksportuan në Kosovë 448 mijë tonë mallra, nga 748 mijë tonë në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ose 40 për qind më pak. Për të njëjtën

periudhë u importuan nga Kosova 123 mijë tonë mallra në janar - gusht 2022, nga 141 mijë tonë në të njëjtën periudhë të vitit 2021 ose 12 për qind më pak. Dy shtete të një populli të ndarë sa larg e sa afër", ka shkruar Gërxfalio në "Facebook".



KADRI ZEKA NGA PROJEKTUESIT E PARË TË MËDHENJ TË ARDHMËS SË LIRË TË ATDHEUT



Ismet SYLEJMANI

Udhëheqësi i madh dhe i lavdishëm i Kosovës dhe i Viseve të saja nën ish-Jugosllavi, i madhi dhe i pavdekshmi, Heroi i Kombit Kadri Zeka, është përfaqësuesi më eminent i bijëve të mëdhenj e besnik të Atdheut, që me tërë potencialin e tyre iu kundërvunë Serbisë pushtuese dhe republikave tjera ish-jugosllave, që mbanin të okupuara pjesë të ndryshme të teritoreve shqiptare të Atdheut tonë!

Heroi i Kombit Kadri Zeka, është një nga lindjet më të madha të Kombit, është jeta e madhe në jetën e kombit, është rënia e madhe në rëniet e mëdha për të ardhmen e ndritur të kombit shqiptar!

Kadri Zeka Ilegali i ngjeshur palë-palë dhe i paketuar me mbështjellje të hekurt e të çelikut të veprimtarit të vendosur e sypatrembur, ishte njëri prej anëtarëve me të spikatur të Komitetit Drejtues të GMLK-së në Kosovë, dhe njëri prej drejtuesve më konsekuent të kësaj orgnizate, e cila është baza dhe themeli më i madh dhe më i fortë, në truallin e të cilit, lindën njëra pas tjetrës lëvizjet dhe partitë politike çlirimtare kombëtare dhe në fund edhe ushtritë çlirimtare në Kosovë dhe Vise, të cilat me luftën heroike dhe titanike të armatosur çlirimtare, bënë realitet ëndrrat dhe projektet e mëdha kombëtare të të rënëve për liri, çlirim e pavarësi!

Kadri Zeka, organizatori i talentuar, tribuni historik i demonstratave dhe mitingjeve të puntorëve e mërgimtarëve shqiptar në Zvicërr, u shëndrrua në superyll të madh ndriques të rrugës për liri të popullit shqiptar të Kosovës dhe Viseve të saja!

Atëherë ku rregjimi gjakatar shtypte me dhunë e terror, me rrahje masive, me burgosje e me arrestime, çdo tentim për të organizuar demonstrata e protesta, apo edhe çdo demonstratë dhe protestat i shuante me gjakderdhje, me ushtri e polici, kordone që mbillnin vdekje kudo, Heroi i Kombit Kadri Zeka, nëpër sheshet dhe rruget e metropoleve në perendim, ngriste zërin dhe i tregonte gjithë botës se sa shumë është duke vuajtur nga zgjedha e Serbisë pushtuese Kosova dhe populli i saj, por edhe Viset tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi!



KADRI ZEKA

Pushtuesit serbo-jugosllav dhe tradhëtarët shqiptar, me shqiptarin e madh e heroik Kadri Zeka, patën probleme të mëdha, prandaj dhe vrasja e Tij dhe e Vëllezërve Gërvalla, me atentat, me gjasë ishte e pashmangshme, sepse uragani Kadri Zeka, siç kishte filluar tërë Europën do ta ngriste në këmbël!

Kadri Zeka, u bë tmerri i ambasadorëve e konzujve të diplomacisë Jugosllave në Zvicërr e në Gjermani në veçanti, por edhe nëpër tërë botën në përgjithësi!

Kadri Zeka është kryediplomati i parë i madh ilegal i popullit shqiptar të Kosovës dhe Viseve të

saja nën ish-Jugosllavi!

Kadri Zeka është kryeambasadori i parë i madh ilegal i popullit shqiptar të Kosovës dhe Viseve të saja nën ish-Jugosllavi!

Të gjithë ambasadorët shqiptar nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut, duhet ta mbajnë portretin e Heroit të Kombit Kadri Zeka, në kabinetin e tyre, sepse Kadri Zeka ishte dhe mbetet i pari shqiptar atdhetar e patriot, që me aktivitetin e Tij, u bë ambasadori epik i popullit shqiptar në Europe dhe në gjithë globin!

Kadri Zeka është themeluesi modern i bashkimt të madh dhe të paparë e të pandarë të

diasporës shqiptare në përgjithësi dhe të asaj të Kosovës në veçanti!

Te roli i i madh e kolosal i Heroit të Kombit Kadri Zeka, duhet të kërkohet krijimi i dashurisë së madhe epike të diasporës shqiptare për vendlindjen, për Atdheun e për Kombin!

Atentati ndaj Kadri Zekës, Jusuf e Bardhosh Gërvallës me 17 Janar 1982 në Untergruppenbah afër Shtutgardit në Gjermani, u shëndërrua në rëniet dhe atentatet më të mëdha kundër luftëtarëve kombëtar jo vetëm jashtë kufinjëve politik të Atdheut!

Aktiviteti titanik e heroik i Heroit

të Kombit Kadri Zeka, por edhe i shumë heronjëve e dëshmorëve të tjerë, të rënë në përpjekjet e mëdha për vetëdijesim, për liri, për çlirim e për pavarësi, u vazhdua nga LPK, e cila në vitin 1994 themeloi UÇK-në, në vitin 2000 themeloi UÇPMB-në dhe në vitin 2001 themeloi UÇK-Kombëtare, të cilat bënë realitet pjesë të mëdha nga ëndrrat e Heroit të Kombit Kadri Zeka dhe të të gjithë të rënëve tjerë, Atdheun e çliruar dhe jetën e lirë dhe të pavarur të popullit shqiptar!

Lavdi Heroit të Kombit Kadri Zeka!

Prishtinë, 17 Tetor 2022!

Është seriali më i ndjekur në “Netflix”, pse të gjithë janë të fiksuar pas vrasësit serial Jeffrey Dahmer?



Nga Gisella DESIDERATO

Në botën e televizionit është hiti i momentit. “Dahmer”, seriali i platformës Netflix i frymëzuar nga historia e vërtetë e Xhefri Dahmerit, vrasësit serial nga Uiskonsin, SHBA, që në vitet 1980 vrau 17 djem të rinj në mënyra makabre, pëlqehet shumë nga audienca në mbarë botën. Por nga ana tjetër ai ka shkaktuar edhe shumë debate: nga të qenit racist dhe homofobik, tek dëshira për të instrumentalizuar dhimbjen. Tashmë edhe syzet e vrasësit serial janë nxjerrë në ankand për shumën e 150 mijë dollarëve, si të ishin objekt kulturi. Me skenarin e Rajan Mërfi (që në vitin 2011 shkroi librin “Historia e tmerreve në SHBA”) dhe Jan Brenan seriali “Dahmer: Historia e një përbindëshi” është një sukses mbarëbotëror.

I disponueshëm në Netflix që nga 21 shtatori, ai arriti shifrën rekord të mbi 196 milionë shikimeve vetëm në javën e parë, duke e çuar atë në krye të listës së serialeve më të shikuara në gjuhën angleze. Ai klasifikohet në 10-n e serialeve më

të mirë të Netflix në 92 vende të botës. Dhe prej disa ditësh është seriali më i ndjekur në Itali.

Pra një triumf, që në fillim nuk mund të cilësohej si i garantuar, pasi ngjarjet e rrëfyera janë ndër më të tmerrshmet që kanë ndodhur ndonjëherë në historinë e dekadave të fundit. Në të rrëfëhet historia e Xhefri Dahmer, një vrasës serial, që përveç ekzekutimit të 17 djemve, kreu akte të dhunës seksuale, nekrofilisë, kanibalizmit dhe copëtimit të viktimave.

Në fakt seriali është klasifikuar si “horror”. Për shembull në serialin me 10 episode tregohet shtëpia e tij, si “muzeu i tmerreve”: me një kokë të prerë të ruajtur në frigorifer, po ashtu disa organe gjenitale, 5 kafka të shpërndara nëpër shtëpi, dhe një skelet mbi komodinë.

Skena të tmerrshme edhe për adhuruesit e këtij zhanri. Se përse po pëlqehet kaq shumë ky serial, ky është objekt i një debati të madh. Seriali është realizuar mirë në aspektin artistik, ai e përcjell shamin e së keqes. Aktori kryesor është rrëqethës në interpretimin e tij, por detajet që tregohen janë të tmerrshme.

Pastaj janë kritikata e forta. Akuzu e

parë është ajo e racizmit. Vrasësi serial veprimi i pashqetësuar për 13 vite (vrau gjatë viteve 1978-1991, në vitin 1992 u dënua me burgim të përjetshëm, dhe 2 vite më vonë u vra nga një i burgosur skizofren) sepse policia i injoroi në vazhdimësi ankesat dhe alarmet e dhëna nga fqinjët.

Dhe kjo fshehu arrogancën dhe ndjenjën e epërsisë të policisë “së bardhë” ndaj “zezakëve”. Ky është një nga elementët që e tërheq më shumë publikun, të paktën gjykuar nga komentet në rrjetet sociale. Prokurori i atëhershëm i Milluokit (ku ndodhi shumica e vrasjeve), Majkëll Mekan u ndje i detyruar të deklaronte në një intervistë për TMZ, se oficerët e policisë nuk do të mbyllnin kurrë sytë ndaj viktimave të Dahmer, vetëm për shkak të racës së tyre apo orientimit të tyre seksual.

“Kjo është një ide qesharake” - u shpreh ai. Por qasjet raciste denoncohen edhe në prapaskenat e serialit. Koordinatorja e produksionit Kim Alsup, tha në një intervistë për gazetën Los Angeles Times tha se ishte “trajtuar shumë keq gjatë xhirimeve”. Ajo saktësoi se ishte një nga vetëm 2 zezake që

punuan për këtë serial, dhe shpeshherë kolegët ua ngatërronin emrat.

Akuza tjetër e fortë është ajo e homofobisë. Në fakt vrasësi serial ishte homoseksual (viktimat e tij ishin djem të rinj) dhe Netflix ka përdorur si tag termin LGBTQ+, për të theksuar homoseksualitetin e Dahmer. Komuniteti LGBTQ reagoi menjëherë duke i kërkuar kompanisë ta fshinte atë, gjë që Netflix e bëri.

Ndërkohë familjarët e viktimave akuzojnë shfrytëzimin e tepruar të dhimbjes së tyre. Gjatë gjyqit ndaj vrasësit serial, në proces u thirr për të dëshmuar Rita Isabel, motra e njërit prej viktimave, Errol Lindsey, që u vra kur ishte vetëm 19 vjeç.

Erik Perri, kushëriri i Errol, postoi në Tëiiter dëshminë e vërtetë të Isabel, duke e krahasuar atë me atë të rikrijuar nga Netflix, duke shkruar: “A na duhen ende këta filma? Nuk më takon mua t’ju them se çfarë të shihni në ekran. Krimi tërheq gjithmonë audiencën. Por nëse jeni vërtet kureshtarë të mësoni këndvështrimin e viktimës, familja ime është shumë e zemëruar me këtë serial. Nuk kishte nevojë të

traumatizohet përsëri, dhe për çfarë?”.

Problemi është se familjarët e viktimave nuk janë kontaktuar nga Netflix, ndaj mungon versioni i tyre. Rita Isabel e bëri të qartë këtë: “Kur pashë një pjesë të serialit, u mërziua shumë, pasi më ktheu të gjitha emocionet që ndjeva në atë kohë. Netflix duhet të kishte kërkuar mendimin tonë apo të na pyeste mbi atë që ndjejmë. Do të ishte mirë që një pjesë e të ardhurave t’u jepeshin të afërmeve të viktimave. Por kjo gjë nuk po ndodh. Është e trishtueshme që ata po fitojnë para nga kjo tragjedi. Është një lakmi e pastër”.

Edhe kritika profesioniste e këtij zhanri e ka ngritur zërin mbi disa aspekte të serialit. Për shembull revista “Variety” e kritikoi atë për “humanizimin” e tepruar të Xhefri Dahmer. Edhe më të ashpra ishin kritikata e “Vanity Fair America” që argumenton se historia që meritonte të nënvizohej, ishte ajo e një komunitetit të marginalizuar me ngjyrë, që dha alarme të cilat ranë në vesh të shurdhër. Ndërkohë, seriali u fokusua tek tmerri i krimeve. / Marrë me shkurtime nga “IoDonna” - bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Pogba, shumë afër rikthimit në fushë

TORINO, 17 TETOR - Paul Pogba është afër rikthimit nga lëndimi. Mesfushori francez kishte pësuar një lëndim serioz me Juventusin, duke bërë që ai t'i nënshtrohej

një operacioni në meniskus. Pogba është jashtë fushave të blerta më shumë se një muaj, por është afër rikthimit në aksion. Kështu së paku ka njoftuar agentja

e lojtarit, Rafaela Pimenta, për "Tuttosport". "Më në fund makthi ka përfunduar. Pogba do të jetë lideri i ri i Juventusit shumë shpejt", ka thënë ajo.

Pogba ka nënshkruar një marrëveshje katërvjeçare me Juventusin në korrik, pasi ai është bashkuar si një lojtar i lirë nga Manchester Unitedi.



Armend Thaqi, 'Ylli i Javës' në Superligë

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), së bashku me sponsorin e Superligës, "Albi Mall", vazhdojnë dhënien e çmimit "Ylli i Javës" pas çdo xhiroje. Çmimi i më të mirit për javën e 11 i ka takuar futbollistit të Ballkanit, Armend Thaqi. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Rifat Nasufi (KFV KEK-u), Isuf Llumnica (KFV Kosova P) dhe Shyqeri Salihu (KFV Lipjani). Armend Q. Thaqi është vlerësuar si bartës i lojës së kampionëve në ndeshjen kundër Drenicës dhe si më i merituari që skuadra e tij i është shmangur humbjes në Skenderaj. Thaqi, i cili po kalon në formë të shkëlqyeshme, ka realizuar golin e barazimit në minutën e 81-të. Çmimi "Ylli i Javës" për Armend Thaqin e ka dhënë Blerta Gashi,

menaxhere e financave në "Albi Online". Thaqi, i cili me paraqitjet e tij ka shkëlqyer edhe në Conference League, ka shprehur besimin se në javët në vazhdim skuadra e tij do t'i radhisë fitoret dhe do të jetë sërish në kreun e tabelës. "Ky çmim për mua është i rëndësishëm së lartë, sepse Superliga e Kosovës është gara në të cilën unë jam rritur dhe jam zhvilluar si lojtar, dhe çdoherë kur shpërblehem për ndeshjet në këtë ligë për mua është kënaqësi e veçantë. Ballkani edhe këtë vit po tregon që është ekip i kompletuar dhe i konsoliduar, me synime të qarta që të jemi kampion sërish. Krahas kësaj, për mua dhe për bashkëlojtarët e mi është nder që po e përfaqësojmë Kosovën dhe futbollin e saj denjësisht edhe në arenën ndërkombëtare", ka thënë Armend Thaqi për faqen zyrtare të FFK-së.



Peja kryeson e pamposhtur në basketboll, Trepça humb pozitën e dytë

PRISHTINË, 17 TETOR - Në fundjavën që lamë pas janë zhvilluar ndeshjet e javës së gjashtë në Superligën e Kosovës në basketboll. Peja ka vazhduar me formën e lartë duke shënuar fitore në udhëtim kundër Bashkimit. Për pejanët kjo ishte fitorja e gjashtë radhazi për të vazhduar si të pamposhtur. Vëllaznimi ka shkaktuar befasi pasi ka fituar ndaj Ponte Prizrenit, teksa fitore ka marrë edhe Sigal Prishtina ndaj

Rahovecit. Golden Eagle Ylli e ka fituar me rezultat të ngushtë derbin ndaj Trepçës. Peja vazhdon të jetë lidere në tabelë edhe pas kësaj jave me 12 pikë, teksa Trepça e ka humbur vendin e dytë, aty ku tani ndodhet Prishtina. Por, këto dy skuadra kanë pikë të njëjta 10. Prizreni renditet i treti me 9 pikë, teksa pozitën 5, 6 dhe 7 ndahen nga Bashkimi, Vëllaznimi dhe Ylli, me nga 8 pikë. Rahoveci është i fundit me 7 pikë.

Ronaldo publikon fotografi me Fergusonin, shprehet i lumtur për takimin me të

MANCHESTER, 17 TETOR - Cristiano Ronaldo është shprehur i kënaqur që ka takuar Sir Alex Alex Fergusonin të dielën. Ky takim

ka ndodhur para ndeshjes së javës së 11-të mes Manchester Unitedit dhe Newcastle Unitedit, e cila është mbyllur baras dhe pa gola. Para fillimit

të kësaj ndeshje, Fergusonin i ka dhuruar Ronaldo një trofe për kujtimor për nder të golit të 700 të shënuar nga portugezi në nivel klubesh.

37-vjeçari këtë shifër e arriti në javën e dhjetë të Premierligës, kur ka shënuar gol në fitoren 1:2 të "Djajve të Kuq" kundër Evertonit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

QENDRA E KOMPETENCËS “Kujtim Krasniqi” MALISHEVË

Nr. Prot: 563 /4
Datë: 17/10/2022
Vendi: Malishevë

NJOFTIM

Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë njofton të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar për aplikim se:

Lëshohet në shfrytëzim (Qera), Restoranti i Qendrës së Kompetencës.

- Me kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi + një vite.

Të interesuarit materialin dhe informatat e nevojshme mund t'i marrin në zyrën nr. 4 në objektin e QK-së nga data 18/10/2022 deri me datën 01/11/2022 prej orës 8:00-15:00

Hapja e ofertave behet me daten 02/11/2022 nga ora 13:00.

Per informata shtese kontaktoni:

Xhevdet Krasnqi nr. i tel. 044/ 314-739

Drejtori

Nazmi Zogaj



QENDRA E KOMPETENCËS MALISHEVË

Kriteret për qiradhënien e restorantit të shkollës

Qendra e Kompetencës në Malishevë posedon restorantin me të gjitha pajisjet më moderne nga fusha e gastronomisë. Kapaciteti i tij siguron plotësimin e nevojave dhe ditore për të gjithë stafin dhe nxënësit e shkollës.

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për stafin dhe nxënësit, Bordi i Qendrës së Kompetencës mori vendim në janar 2013 që, restoranti i shkollës ti jepet në shfrytëzim operatorit i cili i plotëson kriteret e poshtë shënuara.

Parakushtet për kualifikim:

- Operatori duhet të ketë biznesin e regjistruar ne Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe të jetë tatimpagues i rregullt në Administratën Tatimore të Kosovës.
- Operatori duhet të ketë traditë së paku 1 vjeçare në fushën e gastronomisë.
- Të ketë në stafin e tij punëtorë të kualifikuar/certifikuar në fushën e gastronomisë.
- Te mos ketë borxh ndaj institucionit shkollor.

Vërejtje: Për të gjitha parakushtet e lartshënuara kërkohet dëshmia dhe dokumentacioni plotësues! Operatorët ekonomik të cilët nuk i plotësojnë parakushtet, nuk do të kualifikohen në procesin e tenderimit!

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të restorantit të Qendrës së Kompetencës – Malishevë

Të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë kualifikuar, do t'u nënshtrohen kriterëve të poshtë shënuara.

1. Çmimi i qirasë së restorantit (5 pikë)

2. Çmimet e produkteve të kuzhinës..... (4 pikë)

Kërkohet: Lista e produkteve të kuzhinës që do të shërbehen në restorant dhe çmimet për secilin produkt, përfshirë edhe sasia e ushqimit që do të servohet, e matur me kilogram (kg., gr.). Ofrimi i një assortimenti të gjerë të produkteve

Kërkohet: lista e produkteve të cilat do të shërbehen në restorant

Cilësi e garantuar në produkte dhe shërbim

Kërkohet: Kontrollimi i ushqimit në baza ditore për minimizimin e rreziqeve të helmimit dhe problemeve shëndetësore të nxënësit dhe stafit.

Plotësimi i kërkesave të stafit në lidhje me produktet dhe shërbimet

Cilësia e shërbimeve.

3. Dëshmia profesionale (certifikata, diploma) për fushën e hotelierisë të stafit të operatorit ekonomik. (1 pikë)

Fituesi i tenderit do të përcaktohet nga kombinimi i pikëve të fituara për secilin kriter të lartshënuar. Operatori me numrin më të madh të pikëve totale do të jetë fituesi i tenderit.

Sukses!

Drejtori
Nazmi Zogaj



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Home -Styles” SH.P.K. Adrian Salihu, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810118499 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Home -Styles” D.O.O. Adrian Salihu, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810118499 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Home -Styles” L.L.C. Adrian Salihu, has come to the decision to quit its business: 810118499 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "VR-Hydrokos" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810796592 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "VR-Hydrokos" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810796592 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "VR-Hydrokos" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810796592

the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fatmir Bogujevci shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Abdyl Frashëri".

- Behxhet Zeka, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Shtjefën Gjeqovi".

- Gjon Paluca shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Rejall Shope shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Lorena Binaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Vëllezërit Frashri " Pllanej.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobiluar "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L